# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-460688**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Manovrat me mishin nga Brazili/ Ministria bllokon vetëm pulën dhe viçin, por lejohet derri. BE ka standard tjetër |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/20/manovrat-me-mishin-nga-brazili-ministria-bllokon-vetem-pulen-dhe-vicin-por-lejohet-derri-be-ka-standard-tjeter/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 17:47:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 20 shtator 2026, 17:40:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 20 shtator 2026, 17:39:00 UTC → 20 shtator 2026, 17:41:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `966ce5a17515c816800eb4381e25dc948b5b0151c3022174812a7623e5037e65` |
| TEKSTI | `5156e02bdb72c89d12e02246f3e9d3a7abec302d8fd4fde2c2b671f5b3d1087c` |
| PAMJA | `3d656d781a19dcb03f0081530789fdcb793edf1a2d11ab9a71d757de284a2994` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `812889c9f5cd4778df098fc94c23e20a5013339fd7d1b4cac2c220c6161ff870` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e2945722f337a24a4a420f547970a54f85bbd4148edb6362f4a6ae2b4457515b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/812889c9f5cd4778df098fc94c23e20a5013339fd7d1b4cac2c220c6161ff870`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Manovrat me mishin nga Brazili/ Ministria bllokon vetëm pulën dhe viçin, por lejohet derri. BE ka standard tjetër

20/09/2026 19:40



**Shqipëria ndjek një qasje të ndryshme nga Bashkimi Europian për mishin që importohet nga Brazili.**

Ndërsa BE-ja mban jashtë tregut edhe mishin e derrit, vendi ynë ka ndaluar vetëm pulën dhe viçin, duke lejuar vijimin e importit të derrit nga stabilimente që nuk janë të njohura nga Europa.

Ky vendim i Ministrisë së Bujqësisë për të lejuar industrinë e përpunimit të mishit të ushqejë shqiptarët me mish derri nga Brazili, sipas ekspertëve të sigurisë ushqimore, ngre dyshime të mëdha mbi cilësinë e mishit. Ndjekim gazetaren tonë Rudina Muça.

Më 3 shtator, Europa i ngriti traun mishit nga Brazili. Shqipëria ndoqi të njëjtën rrugë për mishin e shpendëve dhe të gjedhit, por jo për mishin e derrit.

Ndryshe nga Europa, e cila nuk e ka pranuar mishin e derrit nga Brazili, pasi e konsideron të pasigurt, për Shqipërinë derri nuk përbën problem. Kështu, ne do të vazhdojmë të presim kontejnerë me mish derri, i cili do të përdoret në restorante, fast-food-e dhe në industrinë e sallamit.

*"Kjo masë gjysmake nuk ka asnjë lloj kuptimi nga pikëpamja shkencore apo e vlerësimit të riskut. Qoftë mishi i pulës, i viçit apo i derrit, të gjitha vijnë nga i njëjti vend, që është Brazili, i cili përdor një regjim krejtësisht të ndryshëm nga ai i BE-së sa i përket përdorimit të antibiotikëve"*, shprehet eksperti i sigurisë ushqimore, Edmond Panariti.

Kufizimi i importit të pulës dhe viçit mund të shkaktojë presion mbi çmimin e këtyre produkteve, ndërsa mishi i derrit do të vazhdojë të ketë të njëjtin çmim. Por pyetja është: sa i sigurt është mishi që refuzohet nga BE-ja dhe pranohet nga Shqipëria?

*"Çfarë mund të bëjë Shqipëria për të ruajtur industrinë e përpunimit të mishit? Vetë ministri duhet të ulet me këta prodhues dhe t'i inkurajojë që të ndryshojnë kahun e importit. Kjo mund të bëhet duke krijuar edhe lehtësi fiskale"*, shton Panariti.

Bujqësia dhe siguria ushqimore janë çështje që na prekin të gjithëve. Prandaj, para se ministria të vendosë se çfarë do të hamë, duhet të sigurohet për cilësinë e produktit. Kjo bëhet duke shtuar numrin e analizave laboratorike në PIK, me një qëllim të vetëm: të parandalohet hyrja e ushqimeve të pasigurta dhe të pashëndetshme në pjatat tona.

**Top Channel**


## Kryesore »







## Kryesore



"Shqipëria nuk shitet"/ Protestat në Tiranë, Rama për gazetën gjermane: Zakonisht jam më i mirë kur ndihem i sfiduar
19:30

Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)
12:06

"Qeveria synon të zhvillojë projekte pilot me komunitetet që merren me turizëm", Rama në podkastin "Flasim": Pasuria natyrore është një pjesë thelbësore
11:26

Zgjedhjet rajonale në Gjermani vënë nën presion Friedrich Merz, rezultatet e dobëta të CDU-së mund të hapin debat për të ardhmen e kancelarit
11:19

PSG, Al Khelaifi në telashe, hetohet në Francë për konflikt interesi
14:06

## Më të lexuarat

Sapo ishte ulur për kafe në një lokal, 44-vjeçari tentoi t'i largohej me vrap autorëve, por u vra në mes të rrugës

Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)

U vra me armë zjarri në rrugë, ja kush është viktima në Sarandë, rezulton i arrestuar në 2025

Foto/ Viktima që u ekzekutua njihej me emrin "Tani Ruzhdiut", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes

Meloni paralajmëron masa të reja në shkollat në Itali: Kufizim për nxënësit e huaj dhe ndalim të burkave e hixhabeve

"Për Enverin yll e dritë… Qajnë pleqtë qajnë të rinjtë"/ Korreshi ndan videon nga Lushnja: U glorifikua diktatori brenda muzeut

Detajet/ Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar. Viktimës iu zu pritë nga autorët

Ukraina sulmon për herë të parë Rusinë me raketën balistike 'Pelican', Zelensky: Goditëm objektet e industrisë së naftës

VIDEO/ "Për Enverin yll e dritë…", Biblioteka e Lushnjës përgënjeshtron lajmin e Saimir



"Shqipëria nuk shitet"/ Protestat në Tiranë, Rama për gazetën gjermane: Zakonisht jam më i mirë kur ndihem i sfiduar

20/09 19:30



"Po të kthehesha pas, do të jetoja të njëjtën jetë"/ Kompozitori Gjergj Leka zbulon sekretin e rinisë: Më dënuan të punoja me 2700 vajza

20/09 19:15



Zgjedhjet në Gjermani/ Godit CDU e Merz, AfD merr një tjetër fitore

20/09 18:42



Video/ Reali i Mourinhos bie në "Metropolitano", Atletico merr tre pikët në derbin e parë të Madridit këtë sezon

20/09 18:18



Ukraina sulmon për herë të parë Rusinë me raketën balistike 'Pelican', Zelensky: Goditëm objektet e industrisë së naftës

20/09 18:08



Spektakël në "Selman Stërmasi", Tirana dhe Elbasani ndajnë pikët në një barazim me katër gola

20/09 17:58

## Sociale »



Shkodër, rritet numri i studentëve/ Më shumë regjistrime në "Luigj Gurakuqi", dega e infermierisë mbetet më e kërkuara

20/09 12:23



Historia shqiptare përmes AI, Xhulio Vasiu kthen kujtimet dhe traditat në filma vizatimorë për fëmijë

19/09 15:50



Breshëri shkatërron perimet, fermerët e Biranjit dhe Lumalasit humbin prodhimin nga goditjet e motit

19/09 12:47



"Pas shkolle" në 408 shkolla/ Detyra dhe klube deri në orën 15:00, ekspertët ngrenë pikëpyetje për kushtet

19/09 12:31



Shkolla me tre nxënës/ Fshati i Këlcyrës po boshatiset, sfida e nxënësve dhe mësuesve rruga e vështirë

19/09 12:23



Ministri Hoxha takim me përfaqësuesin e ri të OBSH-së në Shqipëri: Partneritet për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të kujdesit shëndetësor

18/09 15:59

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Manovrat me mishin nga Brazili! Ministria bllokon vetëm atë të pulës dhe viçit, por...




Top News – Vritet 25-vjeçari shqiptar në Itali. U fut për të grabitur, pronari e ekzekutoi



Top News – Humb jetën tragjikisht 29-vjeçari- Po peshkonte me shokët, mbytet në lumin Drin







Korreshit: Ja si qëndron e vërteta

Përshkallëzohet konflikti mes Jemenit dhe Arabisë Saudite, breshëri dronësh nga Huthit: Përgjigje ndaj 300 sulmeve ajrore



Top News – Trump do t'i ndryshojë emrin IA / 'Duhet ta quajmë Inteligjencë Supreme ose Ekstreme'

Top Channel/ 'Toyota Auris' përfshihet nga flakët pranë kthesës së Picarit, shkrumbohet e gjitha

Top News – Trump kthehet urgjentisht në zyrë / SHBA lëshon alarmin: Përshkallëzim në Arabinë Saudite



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.